



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 12/08/21 Ref.: 3034/21

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funksonimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (Gazeta Zyrtare Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-31 (Gazeta Zyrtare Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (Gazeta Zyrtare Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), si dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 87-të, të mbajtur më 07 dhe 27 Korrik 2021, mori:

V E N D I M

- I. Validohet akreditimi ndërkombëtar i programeve të studimit të Kolegjit Heimerer për periudhën 1 tetor 2021 – 30 shtator 2026:
 - Infermieri - Praktika e Avancuar Infermierore (ANP), MSc, 120 ECTS, maksimumi 50 studentë për vit akademik;
 - Shkencat Mjekësore Laboratorike, MSc, 120 ECTS, maksimumi 30 studentë për vit akademik;
 - Shkencat Shëndetësore për Profile Terapeutike, BSc, 180 ECTS, me specializimet: 1. Logopedi, 2. Ergoterapi, maksimumi 120 studentë për vit akademik (80 studentë në Logopedi dhe 40 studentë në Ergoterapi)
- II. Obligohet Kolegji Heimerer që deri më datë 1 tetor 2021 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna në raportin final të ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.


Arsyetimi

I. Kolegji Heimerer ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për validim të akreditimit të programeve të studimit të cekura në dispozitivin I të këtij vendimi. Vendimi është marrë në bazë të certifikatave dhe dëshmive të ofruara, rreth akreditimit të këtij institucioni nga Agjencia EVALAG, e cila është anëtare e Rrjetit Evropian të Sigurimit të Cilësisë (ENQA).

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerrë këtë vendim bazuar në Nenin 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit Heimerer;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Ass. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

